

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Protesta e 106-të në Tiranë/ Policia vë nën hetim 20 protestues: Prishën qetësinë publike
ADRESA	https://boldnews.al/2026/09/14/protesta-e-106-te-ne-tirane-policia-ve-nen-hetim-20-protestues-prishen-qetesine-publike/
BURIMI	boldnews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 09:46:27 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 09:42:28 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	90e70dfb0d5651d8235c79466554f826695e9e4cc2e6de3c3ef7a1ee9b909a2e
TEKSTI	f7f21023b9e18082a4124b9b3e930dd69ea75fe80c759a3ed6e87808a6ee6c33
PAMJA	60a3f50a69e6ca63357417b7fb976ed5f788d64bfbb9715936f72b5fceb2809b

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	77b3280f54982bb2d5b140bf7b029efb8ddea07adb15c2d4e9ddfc879afed59c
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	e4ff47e3158deeff08239dfd88de708dba9085a414711b421c21bd29dcd303ca
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon një rën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/77b3280f54982bb2d5b140bf7b029efb8ddea07adb15c2d4e9ddfc879afed59c>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Fillimi > AKTUALITET

Protesta e 106-të në Tiranë/ Policia vë nën hetim 20 protestues: Prishën qetësinë publike

11:42:14/09/2026 në AKTUALITET, KRONIKE



Njëzet protestues janë vënë nën hetim nga policia e Tiranës pasi gjatë protestës së 106 që u zhvillua mbrëmë në kryeqytet, bllokuan lëvizjen në akset kryesore të kryeqytetit.

“Në vijim të veprimeve hetimore dhe procedurale të kryera me qëllim dokumentimin e veprimeve të kundërligjshme të kryera gjatë këtij tubimi dhe nxjerrjen përpara përgjegjësisë penale të autorëve të tyre, specialistët e Komisarariatit të Policisë Nr. 2 referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për 20 pjesëmarrës, konkretisht për shtetasit:

Sh. B., 33 vjeç; V. D., 29 vjeç; B. K., 36 vjeç; A. P., 49 vjeç; I. M., 28 vjeç; A. J., 39 vjeç; A. K., 46 vjeç; G. P., 37 vjeç; A. Ll., 28 vjeç; I. M., 24 vjeç; E. K., 27 vjeç; A. N., 26 vjeç; S. E., 32 vjeç; A. Ll., 20 vjeç; M. Y., 19 vjeç; A. B., 59 vjeç; D. G., 50 vjeç; B. M., 34 vjeç; R. Sh., 22 vjeç dhe A. K., 29 vjeç.

Këta shtetas, dyshohet se nëpërmjet organizimit dhe pjesëmarrjes në tubim, kanë bllokuar lëvizjen e qytetarëve dhe të mjeteve, si dhe kanë prishur qetësinë publike, në akset kryesore të kryeqytetit, konkretisht bulevardet “Dëshmorët e Kombit”, “Bajram Curri” dhe “Gjergj Fishta”, në sheshin “Ëilson” dhe në rrugët “Sami Frashëri” dhe “Abdyl Frashëri”. - njofton policia.

Lexo edhe:

[Protesta te Zogu i Zi, 10 të shoqëruar, tubimi transferohet te komisarati nr.1](#)

[Përplasje mes policisë dhe protestuesve pranë shkollës “Qemal Stafa”, dhjetëra të shoqëruar](#)

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për veprime të mëtejshme për veprat penale “Organizimi dhe pjesëmarrja në grumbullime dhe manifestime të paligjshme”, “Pengimi i qarkullimit të mjeteve të transportit” dhe “Prishja e qetësisë publike”.

TË GJITHA



Protesta e 106-të në Tiranë/ Policia vë nën hetim 20 protestues: Prishën qetësinë publike

11:42:14/09/2026



“Partizani”/ Malltezi kallëzon Ballën në SPAK: Ka bërë të paktën 12 deklarime të pavërteta

11:40:14/09/2026



Shqiptarët në SHBA njoftuan protestë kundër vizitës së Ramës në Miçigan, PD: Po kërcënohen familjarët e tyre në Shqipëri

11:24:14/09/2026



Dosja “Partizani”, shtyhet seanca gjyqësore për Berishën

11:13:14/09/2026



PD kërkon Komision Hetimor për KAYO-n, Balliu: Të hetohen partneritetet, kontratat dhe lidhjet me sigurinë kombëtare

11:06:14/09/2026



Trafikanti shqiptar i shpëton burgut në Angli: E dashura ime vuan nga depresioni/ EMRI

11:03:14/09/2026



I dërguari i Trump, me mision lobimi në Tiranë për rizgjedhjen e kreut të FIFA

10:59:14/09/2026

Lajme të lidhura



Protesta te Zogu i Zi, 10 të shoqëruar, tubimi transferohet te komisariati nr.1

10:58 : 14/09/2026



Përplasje mes policisë dhe protestuesve pranë shkollës "Qemal Stafa", dhjetëra të shoqëruar

10:20 : 14/09/2026



Protestuesit zhvillojnë tubim në ditën e parë të shkollës, bllokojnë Zogun e Zi. Shoqërohen disa prej tyre

09:55 : 14/09/2026



Nisja e vitit të ri shkollor shkakton kaos në qarkullim, rradhë kilometrike deri në afërsi të Paskuqanit

09:32 : 14/09/2026



"Rama na preu në besë"/ Divjaka kundër Territoriale: Nuk pranojmë të bashkohemi me Lushnjen

22:00 : 13/09/2026



"Mërgata të na bashkohet"/ Aktivisti Kola: Nga nesër grumbullimi në shesh nis në orën 18:30

20:44 : 13/09/2026



RRETH NESH

Boldnews.al mbetet zgjedhja e parë për një lexues i cili kërkon të informohet me saktësi për një lajm. Misioni jonë kryesor është paanshëmëria dhe profesionalizmi dhe për këtë janë të punësuar gazetarët më të mirë në tregun mediatik.

Na kontakto:

NA NDIQ

